

REPUBLICA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

Nr. Prot. 2048

Tiranë, më 19.10.2015

KONTRATË

Sot më datë 19.10.2015, është lidhur kjo kontratë, midis palëve të mëposhtme (këtu e në vijim referuar si "Kontrata"):

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), themeluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, me numër unik identifikimi (NIPT) K72301452S, me seli në adresën Rruga Papa Gjon Pali II, Nr.3, Tiranë, e përfaqësuar në këtë Kontratë nga Drejtor i Përgjithshëm Znj. Mirlinda Karçanaj, këtu e në vijim referuar si "Autoriteti Kontraktor" ose "Porositësi" nga njëra anë,

dhe

Bashkimit të operatorëve ekonomikë:

"IkubINFO" Shpk themeluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS) L11712002T, dhe adresë respektivisht Rruga "Abdyl Frashëri", EGT-Tower, P. 11/1, Kati 2, Tiranë, të përfaqësuar në këtë Kontratë nga Z. Romeo Sherko.

"Infosoft Systems" Shpk themeluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS) J61820021C, dhe adresë respektivisht Rruga "Murat Toptani", Gjergji Center, Tiranë, të përfaqësuar në këtë Kontratë nga Z. Grigor JOTI;

Shoqëria "IkubINFO" Shpk është shoqëria përfaqësuese e bashkëpunimit me ane te Prokurës se Posaçme me Nr.4632 Rep/ Nr. 542 Kol, date 29.07.2015.

që më poshtë do të quhen "Kontraktori" ose "Ofruesi i Shërbimit", nga ana tjetër.

Porositësi/Autoriteti Kontraktor dhe Ofruesi i Shërbimit/Kontraktuesi referohen këtu e në vijim bashkërisht si "Palët", ose veçmas si "Pala".

Baza Ligjore: Ligji Nr.9643 dt.20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM Nr. 914, dt.29.12.2014 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", dhe Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.



Emil

Page 1 of 14
ARS

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS
Shërbimet – Procedura e Hapur

Neni 1
Qëllimi

Nëpërmjet kësaj Kontrate, Kontraktuesi merr përsipër realizimin e kontratës me objekt: "Sistemi multifunksional i lejeve të ndërtimit" ku përfshihet edhe mirëmbajtja për 4-vjet.

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Shërbimeve të prokuruar me anë të procedurës së hapur.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë ri - shprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë ri shprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjane kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

Kushtet e kontratës, përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2
Vlera e Kontratës

Vlera totale e kontratës është:

- 96,492,000 (nëntëdhjetegjashtëmilion e katërqindnëntëdhjetedymijë) lekë pa tvsh.
- ose
- 115,790,400 (njëqindpesëmbëdhjetëmilion e shtatëqindnëntëdhjetëmije e katërqind) lekë me tvsh.

e detajuar sipas shërbimeve të mëposhtëme:

1	2	3	4	5	6
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Sasia	Çmimi Njësi	Çmimi Total	Afati ne Muaj
1	Sistemi multifunksional i qenderzuar i lejeve te ndertimit	1	40,081,082	40,081,082	4
2	Sistemi multifunksional i qenderzuar i lejeve te ndertimit: Nderveprimi AKPT - DPGJC	1	1,002,027	1,002,027	1
3	Sistemi multifunksional i qenderzuar i lejeve te ndertimit: Nderveprimi AKPT - QKR	1	4,008,108	4,008,108	1

Handwritten signature



4	Sistemi multifunksional i qenderzuar i lejeve te ndertimit: Nderveprimi AKPT - QKL	1	2,505,068	2,505,068	1
5	Sistemi multifunksional i qenderzuar i lejeve te ndertimit: Nderveprimi AKPT - ZRPP	1	2,505,068	2,505,068	1
6	Sherbime Infarstrukture	1	4,824,600	4,824,600	2
7	Servera	3	642,000	1,926,000	2
8	Server DIS dhe konfigurim	1	670,000	670,000	2
9	Mirembajtje	48	811,876	38,970,048	48
Çmimi Neto në Lekë				96,492,000.00	
TVSH (20%) në Lekë				19,298,400.00	
Çmimi Total në Lekë				115,790,400.00	

Neni 3 Kohëzgjatja e Kontratës

- 3.1 Kjo Kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët dhe do të ketë efekte deri në përbushjen e plotë të detyrimeve kontraktuale.
- 3.2 Afati i realizimit të shërbimeve sipas specifikimeve të pikës 10, AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT, referuar aneksit teknik është 12 muaj periudha e zbatimit dhe 4-vjet mirëmbajtja.

Neni 4 Përkufizime

- 4.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Blerësit Publik dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentet e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkëngjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentet e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 4.2 "Çmim kontrate" do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontraktore.
- 4.3 "Objekt i kontratës" do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 4.4 "Palë (t)" do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 4.5 "Autoriteti Kontraktor" do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të përkufizuar në ligj.
- 4.6 "Kontraktues" do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
- 4.7 "Shërbime" do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 4.8 "Termet e Referencës" shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

Neni 5 Hartimi i Kontratës

- 5.1 Shpallja e fituesit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentet e tenderit.
- 5.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke materializuar të gjitha marrëveshjet midis palëve.

F. M. H.



Neni 6

Praktikat Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Proces verbaleve

- 6.1 Autoriteti Kontraktues mund t'i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit për Prokurimin Publik.
- 6.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumenteve të tenderit për këtë prokurim.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 7

Informacioni Konfidencial

- 7.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 7.2 Kontraktuesi mund t'i japë nën-kontraktuesit dokumente të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-kontraktuesin një dispozitë që premtion ruajtjen e konfidencës, siç shprehet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 8

Prona Intelektuale

- 8.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 8.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumenteve dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.
- 8.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mos përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.
- 8.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktues në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 9

Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit

- 9.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficientet dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithësi.
- 9.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.
- 9.3 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoritetit Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështetë dhe ruajë gjithmonë interesin publik.
- 9.4 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në marrëdhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetencës së tij në përfaqësimin e Autoritetit Kontraktues.



Em H.

Neni 10
Detyrimet e Veçanta të Kontraktuesit

- 10.1 Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e Referencës.
- 10.2 Kontraktuesi duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues të gjitha shërbimet, në sasi të përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentet, studimet, skicimet dhe planimetritë.
- 10.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

Neni 11
Specifikime dhe Skicime

- 11.1 Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të përgatisë të gjitha specifikimet dhe skicimet duke përdorur sisteme të pranura dhe të njohura në përgjithësi të pranueshme për Autoritetet Kontraktues dhe të marri parasysh standardet më të fundit.
- 11.2 Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë përgatitur në bazë asnjënjese për sa i përket nxitjes së konkurrencës në prokurimin e objekteve të skicimit.

Neni 12
Lejet dhe Licencat

- 12.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurimin e lejeve ose licencave sipas kërkesave të Ligjeve të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e Shërbimeve në këtë kontratë veç rastit kur palët bien dakord ndryshe.

Neni 13
Heqja dhe Zëvendësimi i Personelit Kryesor

- 13.1 Kontraktuesi duhet të sigurojë aprovim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç përshkruhet në ofertën e Kontraktuesit.
- 13.2 Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës nëse Autoriteti Kontraktues zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme ose Autoriteti Kontraktues është mjaft i pakënaqur nga puna e personit.
- 13.3 Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Kontraktuesi duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime ekuivalente ose më të mira.
- 13.4 Kontraktuesi do të paguajë kosto shtesë për zëvendësimin e personelit kryesor me përjashtim kur shkak i zëvendësimit ka ardhur nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit të Autoritetit Kontraktues.

Neni 14
Vendndodhja

- 14.1 Shërbimet duhet të kryhen në vendin ose vendet e specifikuar në kontratë.
- 14.2 Nëse nuk është specifikuar vendi, Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të aprovojë vendin ose vendet e kryerjes së Shërbimeve, megjithatë, aprovimi nuk duhet të vonohet në mënyrë të paarsyeshme.

Neni 15
Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale

- 15.1 Kontraktuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithësi për profesionin për ta zhdëmtuar Autoriteti Kontraktues për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.
- 15.2 Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Kontraktuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithësi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shërbimeve që po sigurohen.



Neni 16
Çmimi i Kontratës

- 16.1 Çmimi i kontratës duhet të jetë çmimi i ofruar në ofertën e Kontraktuesit dhe i pranuar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 17
Afatet e Pagesës

- 17.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë çdo pagesë paraprake, duhet të paguhet në kohë siç specifikohet në kontratë.
- 17.2 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit i monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë në ditën kur është dërguar njoftimi i kontratës për botim.
- 17.3 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t'i bëhet Autoriteti Kontraktues me shkrim. Për çdo kërkesë, Kontraktuesi duhet të paraqesë origjinalin dhe kopjen së bashku me një listë të sendeve që përshkruan shërbimet e kryera për të cilat duhet paguar.
- 17.4 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa për shërbimet do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që janë kryer Shërbimet, dorëzimi është paraqitur ose arritur, ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më e vonë.
- 17.5 Data e pagesës do të jetë dita që fondet debitohej nga llogaria e Autoritetit Kontraktues.

Neni 18
Vonesa në Bërjen e Pagesës

- 18.1 Dëmet e llogaritura, të shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë, konsistojnë në kamatën që fillon nga data e vonesës së debitorit (Autoriteti Kontraktues), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamatës parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti, interesi i maturuar i shtohet shumës totale, mbi të cilën është llogaritur interesi i maturuar.
- 18.2 Kamata ligjore paguhet pa detyruar kreditorin (Kontraktuesin) të provojë ndonjë dem. Nëse kreditori (Kontraktuesi) provon se ka pësuar një dëm më të madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktues) duhet të paguajë pjesën e mbetur të dëmit.

Neni 19
Ndryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

- 19.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 20
Forca Madhore

- 20.1 Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e depozitës së kontratës, dëmet e likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.
- 20.2 Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje e paparashikueshme jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktues qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo transiti.
- 20.3 Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë Autoriteti Kontraktues. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktues jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

E m H.



RS

Neni 21

Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

- 21.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.
- 21.2 Me përjashtim të rastit kur Autoriteti Kontraktues është dakord për zgjatje të afatit të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të likuidojë dëmet për vonesën në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në kryerjen e Shërbimeve brenda periudhës së Kontratës.
- 21.3 Autoriteti Kontraktues mund të zbrisë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktues duhet t'i japi kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.
- 21.4 Autoriteti Kontraktues do të jetë dakord për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Madhore.
- 21.5 Autoriteti Kontraktues mund të jetë dakord për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktues me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të përfundimit të Shërbimeve. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktues është dakord me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

Neni 22

Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar

- 22.1 Dëmet e likuidueshme për kryerjen e vonuar të Shërbimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:
 - Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
 - Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës..
 - Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

Neni 23

Negociatat dhe Amendamentet

- 23.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit.
- 23.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qenë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktor.
- 23.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 24

Ndryshimi i Porosisë

- 24.1 Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të porosisë Shërbime shtesë deri në një sasi që nuk kalon 20% të çmimit total të kontratës. Çdo porosi shtesë duhet të bëhet në mënyrë konsistente me rregullat dhe procedurat e parashikuara në Ligjin mbi Prokurimin Publik.

Emil



RS

Neni 25
Ndërprerja për Mosplotësim

- 25.1 Autoriteti Kontraktues mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:
- Kontraktuesi dështon të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
 - Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.
- 25.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

Neni 26
Ndërprerja për Shkak të Falimentimit

- 26.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.
- 26.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

Neni 27
Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

- 27.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.
- 27.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.
- 27.3 Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha Shërbimet e kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjeshme të Shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesi do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

Neni 28
Nënkontrata

- 28.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrëveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë
- 28.2 Kontraktori nuk duhet të nënkontrakttojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor dhe jo më shumë se 40% të vlerës së kontratës.
- 28.3 Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacionin që provon aftësinë e nënkontraktorit.
- 28.4 Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë Kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.
- 28.5 Çdo nën-kontraktor duhet të ketë të drejtë të marrë pjesë në prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Autoriteti mund të parashikojë pagesa direkte tek nën-kontraktori për shërbimet që do të furnizojë.
- 28.6 Kur Kontraktuesi ka ndër mend të realizojë një pjesë të punimeve me nën-kontraktues, duhet të paraqesë në ofertë, sipas dokumenteve të tenderit, gjithë dokumentacionin e kërkuar për nënkontraktuesin si dhe punimet konkrete që do të japë me nën - sipërmarrje.
- 28.7 Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pavarësisht nga sjellja e nën-kontraktorit.

Neni 29
Transferimi i të Drejtave

- 29.1 Kontraktuesi nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktor.



E. M. H.

A. R. S.

Neni 30
Sigurimi i Kontratës

- 30.1 Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor sigurimin e kontratës në shumën dhe formën e kërkuar.
- 30.2 Shuma e sigurimit të kontratës duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 30.3 Sigurimi i kontratës do t'i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së kryerjes së Shërbimeve.

Neni 31
Baza Ligjore

Kontrata do të rregullohet nga dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 32
Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- 32.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.
- 32.2 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së marrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 33
Përfaqësimi i Palëve

- 33.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës.
- 33.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.
- 33.3 Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta njoftimi me shkrim në të cilin rast duhet dhënë dhe duhet të përcaktoje shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

Neni 34
Lajmërimet

Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetër sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 35
Llogaritja e Afateve

Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.



Em H.



RS

KUSHTET E VEÇANTA TË KONTRATËS
Shërbimet – Procedura e Hapur

Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Ne rast se ka mospërpunje midis KPK dhe KVK do të mbizotërojnë ato të Kushteve të veçanta të kontratës.

Neni 36
Përkufizime

"Autoriteti Kontraktor" është Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

"Kontraktuesi" është bashkimi i operatoreve "ikubINFO" Shpk dhe "Infosoft Systems" Shpk.

"Dorëzim" apo **"Dorëzimi i produkteve"** nënkupton kalimin fizik të produkteve nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktor. *Dorëzimi i shërbimeve/punëve nënkupton përfundimin e tyre dhe njoftimin e Autoritetit Kontraktor se shërbimet/punët janë kryer.*

"Koha e përgjigjes" është intervali kohor nga momenti i raportimit të një incidenti ose problemi nga Autoriteti Kontraktor deri në momentin e përgjigjes në telefon, e-mail, ose mjet tjetër të rënë dakord mes palëve, ose deri në momentin e fillimit të diagnostikimit.

"Koha e zgjidhjes" është intervali kohor nga momenti i përgjigjes së parë të Kontraktuesit për një incident ose problem të raportuar nga Autoriteti Kontraktor deri në momentin e riparimit të shkaktarit të incidentit ose problemit, ose të implementimit të një zgjidhjeje të tërthortë.

Neni 37
Sigurimi i kontratës

- 37.1 Sigurimi i Kontratës në shumën prej **11,579,040 (njëmbëdhjetë milion e pesëqindeshtatëdhjetenëntë mijë e dyzetë) lekë**, duhet të ofrohet nga Kontraktuesi për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 37.2 Shuma e sigurimit të kontratës duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje apo difekt të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 37.3 Sigurimi i kontratës do t'i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së kryerjes së Shërbimeve.

Neni 38
Fillimi i Kontratës


- 38.1 Zbatimi i kontratës duhet të fillojë në datën që Kontraktuesi nënshkruan Kontratën.
- 38.2 Personat e autorizuar për ndjekjen e Kontratës

- Për "Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)"

- a) Blerina Pirani me adrese e-mail: blerina.pirani@akshi.gov.al
- b) Mirela Skenderi me adrese e-mail: mirela.skenderi@akshi.gov.al
- c) Igli Ceka me adrese e-mail: igli.ceka@akshi.gov.al
- d) Belinda Vangjeli me adrese e-mail: belinada.vangjeli@akshi.gov.al

- Për bashkimin e operatoreve "IkubINFO" Sh.p.k dhe "Infosoft Systems" Shpk

- A) Albano Qojle me adrese e-mail: albano.qojle@ikubinfo.al
- B) Ermond Parllaku me adrese e-mail: ermond.parllaku@ikubinfo.al



C. EltianShima me adrese e-mail: eshima@infosoftgroup.com.al

Neni 39
Vendndodhja e Shërbimeve

- 39.1 Shërbimet duhet të kryhen në vendin ose vendet e specifikuar në kontratë.
39.2 Nëse nuk është specifikuar vendi, Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të aprovojë vendin ose vendet e kryerjes së Shërbimeve, megjithatë, aprovimi nuk duhet të vonohet në mënyrë të paarsyeshme.

Neni 40
Informacion që duhet dhënë nga Autoriteti Kontraktor

- 40.1 Brenda 30 ditësh nga marrja e sigurimit të kontratës Autoriteti Kontraktor në bashkëpunim me Kontraktuesin do të përgatisin planin dhe afatet për realizimin e shërbimeve të përshkruara në Aneksin Teknik.

Neni 41
Kërkesat e Raportimit

Kontraktuesi do të paraqesë raportet e mëposhtme në Shqip në origjinal në 2 kopje:

Raporti Fillestar prej maksimumi 12 faqesh duhet të prodhohet pas një jave nga fillimi i implementimit. Në raport Kontraktuesi duhet të përshkruaj gjetjet fillestare, progresi në mbledhjen e të dhënave, çdo vështirësi të pritura ose të hasura. Kontraktuesi duhet të vazhdojë me punën e tij derisa Autoriteti Kontraktues të dërgoj komente mbi raportin fillestar

Drafti i raportit përfundimtar i faqeve maksimale 12 (teksti kryesor, duke përjashtuar anekset). Ky raport duhet të dorëzohet jo më vonë se një muaj para përfundimit të periudhës së zbatimit të detyrave.

Raporti final me të njëjtat specifika si drafti i raportit përfundimtar, inkorporimin e komenteve të pranuar nga palët në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit përfundimtar është 7 ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Raporti duhet të përmbajë një përshkrim mjaftueshëm të detajuar Analizat e detajuara që i mbështesin rekomandimet do të prezantohen në anekset në raportin kryesor. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet së bashku me faturën përkatëse.

Neni 42
Kushtet e Pagesës


- 43.1 Pagesa duhet bërë sipas skedarit të mëposhtëm:

- Pagesa e shërbimeve që do të lëvrohen sipas specifikimeve teknike të pikës pika 5 Raportimi, pika 10 Afati kohor I Implementimit (referuar aneksit teknik) si dhe listes së shërbimeve në nenin 2 të kontratës do të realizohet brenda 30 ditëve nga data e pranimit të shërbimeve. Në kushtet që lëvrimet e shërbimeve do të bëhen pjesore, Autoriteti Kontraktor pranon që pagesat të kryhen në mënyrë pjesore për vlerën e shërbimeve të lëvruara, për të cilën palët bien dakord, sipas faturave tatimore përkatëse sipas çmimit të përcaktuar në Formularin e Ofertës.
- Pagesa për shërbimet e mirëmbajtjes sipas pikës 8 MIRËMBAJTJA (referuar aneksit teknik) do të bëhet brenda 30 ditësh, pas dorëzimit të çdo raporti mujor tek Autoriteti Kontraktor (AKSHI) së bashku me faturën mujore sipas çmimit të përcaktuar në Formularin e Ofertës.

"Të dhënat e llogarisë së Kontraktorit:

Banka: Societe Generale Albania

Nr. llogarie: AL75 2131 1044 0000 0000 0094 8935



FMH

RS

43.2 Monedha e pagesës do të jetë lekë.

43.3 Në rast se Qeveria Shqiptare vendos të mos miratojë fondin vjetor lidhur me shërbimin e mirëmbajtjes kontrata do të ndërpritet pa kosto për palët. Njoftimi respektiv do të komunikohet Ofruesit të Shërbimit të paktën 15 dite përpara.

Neni 43 Pagesa Paraprake

Kontraktuesi nuk do të marrë pagesë paraprake.

Neni 44 Zbritja e garancisë së kontratës

Sigurimi i kontratës mbetet i pandryshuar.

Neni 45 Informacion që Duhet Dhënë nga Autoriteti Kontraktor

45.1 Brenda 30 ditësh nga marrja e sigurimit të kontratës Autoriteti Kontraktor në bashkëpunim me Kontraktuesin do të përgatisin planin dhe afatet për realizimin e shërbimeve të përshkruara në Aneksin Teknik.

Neni 46 Kushtet Paraprake për Realizimin e Kontratës

46.1 Për realizimin e shërbimeve sipas objektit të kontratës, Autoriteti Kontraktor (AKSHI), në rolin e koordinatorit midis Kontraktuesit dhe institucioneve me sistemet elektronike të të cilave (backend) këto shërbime do të komunikojnë, duhet të sigurojë për Kontraktuesin autorizimet përkatëse për realizimin e shërbimeve dhe publikimin e informacioneve në portalin e-Albania ose në ESB.

Për realizimin e shërbimeve sipas objektit të kontratës, Autoriteti Kontraktor (AKSHI), në rolin e koordinatorit midis Kontraktuesit dhe institucioneve me sistemet elektronike të të cilave (backend) këto shërbime komunikojnë, duhet të sigurojë për Kontraktuesin pjesëmarrjen e nevojshme të ekspertëve përgjegjës të institucioneve, sa herë që do të nevojitet ndërveprimi me ta për zhvillimin e shërbimeve përkatëse elektronike, apo ofrimin e shërbimeve të tjera, objekt të kësaj kontrate.

46.2 Në kontekstin e menaxhimit të punëve për realizimin e kontratës, Kontraktuesi do të propozojë periudha kohore gjatë të cilave Autoriteti Kontraktor do të marrë vendime (kur vendimet janë të nevojshme). Këto periudha do të përcaktohen së bashku me Autoritetin Kontraktor (sa here që të jetë e mundur), me qëllim përmbushjen e afateve kohore të përcaktuara në këtë kontratë. Nëse Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë në gjendje t'i marrë vendimet brenda periudhave kohore të përcaktuara, ose nuk do të ketë njoftuar për vonesa apo zgjatje periudhe (maksimalisht 10 ditë), atëherë Kontraktuesi mund të vendosë bazuar në standardet praktikat më të mira ndërkombëtare, me qëllim përmbushjen e suksesshme dhe brenda afateve kohore të detyrimeve objekt të kësaj kontrate.

Neni 47 Trajtimi i ndryshimeve

Gjatë periudhës së realizimit të kësaj kontrate, Autoriteti Kontraktor mund të gjykojë të nevojshme të kërkojë ndryshime të kërkesave objekt të kësaj kontrate. Kërkesat për ndryshime do të trajtohen si më poshtë:

- Autoriteti Kontraktor do të formulojë kërkesën për ndryshim dhe do t'ia paraqesë atë Kontraktuesit në formë të shkruar.
- Kontraktuesi do të analizojë kërkesën për ndryshim dhe ndikimin e ndryshimit dhe do të vlerësojë punën e nevojshme e realizimin e ndryshimit.
- Kontraktuesi do t'ia paraqesë Autoritetit Kontraktor ofertën për realizimin e ndryshimit të kërkuar.



Fm

75

- d) Autoriteti Kontraktor do të vendosë nëse do të vazhdohet ose jo me realizimin e ndryshimit.
- e) Nëse Autoriteti Kontraktor do të vendosë për realizimin e ndryshimit, palet do të pasqyrojnë ndryshimet në një amendament, i cili do të bëhet pjesë integrale e kontratës dhe me pas Kontraktuesi do të kryejë punët për realizimin e ndryshimit
- f) Autoriteti Kontraktor do të ndjekë procesin e pranimi të ndryshimit të realizuar.

Neni 48

Pranimi nga Autoriteti Kontraktor i dorëzimeve të Kontraktuesit

Autoriteti Kontraktor (AKSHI) duhet të pranojë punët e kryera dhe dorëzuara nga Kontraktuesi. Pranimi do të kryhet nëpërmjet testimave të pranimi. Kur dorëzimet kanë natyrë të tillë që nuk mund të testohen (p.sh. trajnime, shërbime konsultimi, shërbime suport), realizimi i shërbimeve profesionale përkatëse i shoqëruar me raport që evidenton realizimin është kriteri i pranimi të tyre. Përfundimet e testeve të pranimi do të dokumentohen në formë të shkruar dhe do të nënshkruhen nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

Në rast se i kërkohej nga autoriteti kontraktor që të bëhen ndryshime në shërbim, atëherë pranimi i testimit do të ribehet pasi të jete aprovuar gjatë prezantimit.

Testimi i pranimi do të kryhet si më poshtë:

- a) Për shërbimet e reja elektronike, Kontraktuesi do të njoftojë Autoritetin Kontraktor 5 ditë pune përpara datës së fillimit të testimit që është gati të fillojë testimet e pranimi dhe do të ofrojë propozimet për skenarët e testimit dhe për të dhënat e testimit.
- b) Kontraktuesi do të kryejë instalimet e dorëzimeve tek mjedisi test i Autoritetit Kontraktor.
- c) Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi do të përcaktojnë kohëzgjatjen e testimit të pranimi, por në çdo rast, ajo nuk do të jetë më shumë sesa 10 ditë pune nga data e instalimit të dorëzimeve.
- d) Autoriteti Kontraktor do të zhvillojë testimet e pranimi duke ndjekur skenarët e testimit. Kontraktuesi do të jetë i pranishëm gjatë zhvillimit të testimit nga Autoriteti Kontraktor.
- e) Testimi i pranimi do të dokumentohet në protokollin e pranimi, duke dalluar qartë rezultatin e testimit (me sukses, pjesërisht me sukses, pa sukses) dhe duke evidentuar gjetje ose komente. Protokollin e pranimi do të nënshkruhet nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.
- f) Autoriteti Kontraktor duhet të njoftojë me shkrim Kontraktuesin për pranimin ose jo të dorëzimeve për të cilat u realizua testimi i pranimi jo më vonë sesa 10 ditë pune nga data e realizimit të testimit të pranimi.


N.q.s. Autoriteti Kontraktor gjykon që dorëzimet nuk janë të pranueshme, atëherë ai duhet ta njoftojë me shkrim Kontraktuesin menjëherë dhe të shumtën brenda 10 ditë pune pas kryerjes së testimit të pranimi dhe të specifikojë arsyet e mospranimi të dorëzimeve. Dorëzimet do të quhen të pranuar në çdo rast, përveçse kur Autoriteti Kontraktor identifikon tek to mangësi të tilla që:

- a) Pëngojnë funksionimin e komponentëve objekt të kësaj kontrate nga Autoriteti Kontraktor, apo palë të tjera të përfshira.
 - b) Shkaktojnë kufizime në realizimin e funksioneve të rëndësishme të komponentëve objekt të kësaj kontrate, të tilla që nuk mund të zgjidhen brenda një intervali të arsyeshëm kohe.
 - c) janë zgjidhje provizore që mundesojnë funksionimin e shërbimit por që nuk janë konform standarteve teknike apo pengojnë rihvillimin në kohe të mevonshme.
 - d) Performanca funksionaliteteve është e ulët dhe e padobishme për institucionin përfitues.
- Kontraktuesi duhet të zgjidhë çdo mangësi që mund të jetë evidentuar nga Autoriteti Kontraktor në protokollin e pranimi.

N.q.s. ndonjë nga testimet e pranimi nuk është realizuar brenda 10 ditë pune nga data e instalimit të dorëzimeve, ose n.q.s. Autoriteti Kontraktor nuk ka njoftuar që dorëzimet janë të pranuar brenda afatit të përcaktuar (10 ditë pas kryerjes së testimit të pranimi), atëherë Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor do t'i konsiderojë dorëzimet të pranuar.

Neni 49 Të Ndryshme

49.1 Kjo Kontrate do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët dhe mund të ndryshohet vetëm me miratimin me shkrim nga të dy Palët.





Emil

RS

- 49.2 Kjo Kontratë do të rregullohet, interpretohet dhe zbatohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.
- 49.3 Kjo Kontratë hartohet në 5 (pesë) kopje, ku 3 (tre) kopje janë për Autoritetin Kontraktor dhe nga 1 (një) kopje për Kontraktuesit. Çdo kopje ka të njëjtën përmbajtje dhe të njëjtën vlerë ligjore.
- 49.4 Kësaj Kontrate i bashkëngjitet: Aneksi Teknik - Termat e Referencës, Propozimi Teknik paraqitur ne ofertën fituese te cilat janë pjesë integrale e kësaj kontrate si formulari i Sigurimit të Kontratës lëshuar nga kompania ALBSIG me nr..21517930.

Autoriteti Kontraktor

Agjencia Kombëtare të Shoqërisë së
Informacionit (AKSHI)



Mirlinda KARCANAJ


Kontraktuesi

IkubINFO Shpk


Romeo SHERKO


InfoSoft Systems Shpk


Grigor VON
